VENDIM
Nr.34, datë 19.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i tretë i pikës 4 të vendimit nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Pagesa e aftësisë së kufizuar, për të verbrit dhe kujdestarët e tyre, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha